



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 27.11.2025
Numër Protokolli: 7703/2025

A.nr.1311/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1311/2025, të datës 08.07.2025, të parashtruar nga ankuesi S.J, kundër organit të punësimit: Ministrisë së Mbrojtjes, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e më datë 27.11.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.1311/2025, e datës 08.07.2025, e parashtruar nga ankuesi S.J, ashtu që, **anulohet** Njoftimi i datës 25.06.2025, i Departamentit për Politikën e Personelit dhe Rekrutimit i Ministrisë së Mbrojtjes lidhur me shpalljen e rezultateve përfundimtare për procedurën e pranimit me numër reference: RN00017454, për pozitën Inspektor i Përgjithshëm, si dhe çdo veprim administrativ i ndërmarr në fazën e verifikimit paraprak dhe fazën e vlerësimit profesional, ndërsa, *procedura e pranimit kthehet në fazën e verifikimit paraprak.*

II. Obligohet Departamenti për Politikën e Personelit dhe Rekrutimit i Ministrisë së Mbrojtjes që në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi të ndërmerr çdo veprim të nevojshëm për zbatimin e këtij vendimi sikurse përcaktohet në pikën I të dispozitiv.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet për veprimet e ndërmarra.

A r s y e t i m

Ankuesi S.J (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), më datë 08.07.2025, përmes emailit ankesa.kmpshck@rks-gov.net, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Njoftimit të datës 26.05.2025, të Departamentit për Politikën e Personelit dhe Rekrutimit të Ministrisë së Mbrojtjes për refuzimin e aplikacionit lidhur me konkursin më numra reference: RN00017454, për pozitën Inspektor i Përgjithshëm, të shpallur nga Ministria e Mbrojtjes.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Mbrojtjes, ndërsa, kjo e fundit ka dorëzuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas konstatimit së ankesa është e pranueshme në kuptim të nenit 129 të LPPA-së (në tekstin e mëtejshëm referuar: Kolegji i Këshillit), ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 4556/2025 të datës 08.07.2025 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkursin me Nr. Reference: RN00017454 për pozitën Inspektor i Përgjithshëm; Kopjen e ID-së së ankuesit; Vendimin me numër protokolli 773 të datës 29.12.2023; Akt Emërimit me Nr. 395/2025 të datës 31.01.2025; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 14.07.2025; Përgjigjen në ankesë e datës 17.07.2025; Listën e aplikantëve; Vendimin Ref.DBN-MM-5/495/2025 të datës 12.05.2025 për shtyrjen e afatit të verifikimit të aplikacioneve; Vendimin e datës 26.05.2025 për verifikimin paraprak; Vendimin me Nr. 3/266/225 të datës 06.05.2025 për emërimin e komisionit të pranimit; Akt Emërimet/Kontratat/Vendimet dhe Urdhrit e Emërimit për anëtarët e komisionit të pranimit; Njoftimin e datës 26.05.2025 për refuzimin e aplikacionit të ankuesit; Njoftimin për testim me shkrim i datës 04.06.2025; Formularin e vlerësimit të përgjithshëm të eses i datës 13.06.2025; Testin me shkrim; Njoftimin e datës 13.06.2025 për kandidatët që kanë kaluar testin me shkrim; Njoftimin për intervistë i datës 18.06.2025; Njoftimin për kandidatët për intervistë' Listën e pyetjeve të intervistës datës 24.06.2025; Formularët e vlerësimit të intervistës i datës 24.06.2025; Formularin e renditjes përfundimtare të kandidatëve i datës 25.06.2025; Njoftimin për rezultatet përfundimtare i datës 25.06.2025; Aplikacionin e kandidat I.H i datës 03.04.2025 me dokumentacionin nga faqe 1-21; Aplikacionin e ankuesit i datës 06.04.2025 me dokumentacionin nga faqe 1-33.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ ka gjetur së ankesa e ankuesit **është e bazuar, sepse:**

Vlerësimi i gjendjes së fakteve

Nga administrimi i shkresave të lëndës rrjedhë :

- Ministria e Mbrojtjes më datë 27.03.2025 ka shpallur konkursin më numër të referencës: RN00017454, për Grupin e Administrimit të Përgjithshëm për pozitën Inspektor i Përgjithshëm në Njësinë e Inspektiveve, klasa profesional 1, me afat aplikimi nga data 28.03.2025 deri 26.04.2025.
- Në këtë konkurs kanë aplikuar 151 kandidatë, ku vetëm 96 prej kandidatëve kanë kaluar fazën e verifikimit paraprak.
- Sipas Njoftimit të datës 26.05.2025, të Departamentit për Politikat e Personelit dhe Rekrutimit në Ministrinë e Mbrojtjes, ankuesit i është refuzuar aplikacioni me arsyetimin se i mungojnë dëshmitë e punësimit të lëshuar nga institucionit përkatës i punësimit.
- Departamenti për Politikat e Personelit dhe Rekrutimit i Ministrisë së Mbrojtjes më datë 25.06.2025, ka publikuar njoftimin për rezultatet përfundimtare lidhur me kandidatet e suksesshëm, ashtu që sipas këtij njoftimi si kandidat më shumë pikë është I.H me gjithsej 93.4 pikë.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundërshton Njoftimin e datës 26.05.2025, të Departamentit për Politikën e Personelit dhe Rekrutimit të Ministrisë së Mbrojtjes për refuzimin e aplikacionit, duke pretenduar se refuzimi i aplikacionit është i padrejtë sepse me rastin e aplikimit ka bashkangjitur të gjitha dokumentacionet përkatëse duke përfshirë edhe atë të përvojës së punës.

Në kuptim të dispozitave të nenit 89 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit ka analizuar konkursin me numër të referencës RN00017454, dhe për pasojë konstatoi se si kritere të përgjithshme formale për pozitën përkatëse të punës kanë qenë: **Arsimimi i kërkuar:** *Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor). Arsim i lartë i paspecifikuar.,* **Përvoja e punës së kërkuar:** *Së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitë së lirë të punës.* e për rrjedhojë Kolegji vlerëson se konkursi është shpallur sipas kriterëve për grupin e përcaktuar në pajtim me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil dhe Katalogun e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.

Ndërsa, duke qenë se pretendimet ankimor kanë të bëjnë me fazën e verifikimit paraprak, kolegji iu referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenit 39, paragrafi 1. 7, ku përcaktohet se: **1. Pranimi në shërbimin civil bëhet në të gjitha kategoritë e shërbimit civil, nëpërmjet një procedure rekrutuese të hapur dhe publike, përveç kur parashikohet ndryshe me këtë ligj. 7. Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 7.1. verifikimi paraprak përmes të cilit verifikohet nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit; dhe 7.2. vlerësimi profesional që përfshin vlerësimin e njohurive dhe cilësive profesionale të kandidatëve.**

Andaj, duke u bazuar në këtë kuadër ligjor Kolegji analizoj aktin e kontestuar në ndërlidhje me provat materiale të çështjes nga dhe konstatoi se sipas Njoftimit të datës 26.05.2025 të Departamentit të Politikave të Personelit dhe Rekrutimit të Ministrisë së Mbrojtjes, ankuesit i është refuzuar aplikacionin mbi shkakun se mungojnë dëshmitë e punësimit të lëshuar nga institucionit përkatës i punësimit, ndërsa, në përgjigjen në ankesë organi i punësimit refuzimin e aplikacionit të ankuesit e mbështet në sqarimit se: **...refuzimi i aplikacionit ka ndodhur për shkak se kandidati nuk ka arsyetuar përvojën e punës së kërkuar pas diplomimit sepse ka diplomuar në bachelor më datë 28.06.2024.** Rrjedhimisht, në vlerësimin e Kolegjit ky konstatim i Ministrisë së Mbrojtjes është i pabazuar ligjërisht dhe mbështet në vërtetim jo të drejtë të gjendjes faktike, sepse, nga analizimi i dokumentacionit të ankuesit të dorëzuar më rastin e aplikimit më datë 06.04.2025 (i përcjell nga MM-ja më përgjigjen në ankesë), ankuesi si dëshmi lidhur me arsimin ka ofruar Diplomën me Nr.132 të datës 28.05.2024, të lëshuar nga Akademia e Kosovës për Siguri Publike/Fakulteti i Sigurisë Publike, me të cilën vërtetohet se ankuesi ka diplomuar më datë 28.10.2022, e jo më datë 28.06.2024, rrjedhimisht data 28.06.2024 të cilës i referohet organi i punësimit ka të bëjë me datën e lëshimit të diplomës e jo datën e përfundimit të studimeve. Ndërsa, lidhur me përvojën e punës pas diplomimit ankuesi ka bashkangjitur si dëshmi Akt emërimit me numër AE.Nr.093/2022 të datës 15.12.2022, për emërim në pozitën Mbikëqyrës në Qendrën Korrektuese në Dubravë, të cilën pozitë e ka ushtruar deri më datë 30.01.2025, ku dhe me pastaj nga data 31.01.2025, ushtron detyrën e Mbikëqyrësit të Lart në Qendrën e Paraburgimit në Pejë (sipas Akt Emërimit me Nr.395/2025 të datës 31.01.2025). Mbi gjendjen e këtyre fakteve rrjedhë se ankuesi ka plotësuar kriteret formale lidhur me pozitën Inspektor i Përgjithshëm, kështu që, njësia përgjegjëse në këtë rast Departamenti për Politikën e Personelit dhe Rekrutimit i Ministrisë së Mbrojtjes më rastin e refuzimit të aplikacionit të ankuesit ka vepruar në kundërshtim me nenin 9, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, duke mohuar të drejtën e anësuesit për përfshirje në listë të ngushtë dhe vijim me procedurë të vlerësimit dhe si rrjedhojë pretendimet ankimore janë tërësisht të bazuara.

Andaj, duke qenë së shkeljet e evidentuar si me sipër, kanë të bëjnë më fazën e verifikimit paraprak, dhe meqenëse akti i shpalljes së konkursit nuk përmban të meta ligjore, kolegji më qëllim të kthimit të ligjshmërisë aprovoj ankesën si të bazuar, anuloi çdo veprim të ndërmarr në fazën e verifikimit paraprak, më detyrimin që njësia përgjegjëse në rishqyrtim të aplikacioneve të merr parasysh pikëpamjet juridike si në arsyetimin e këtij vendimi dhe të bëjë ri shqyrtim të drejtë të dokumentacionit të dorëzuar nga kandidatet në kuptim të përmbushjes së kriterëve të konkursit.

Përmbledhur si me lartë, e në mbështetje të nenit 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.nr.1311/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit S.J;
- Ministrisë së Mbrojtjes: Sekretarit të Përgjithshëm dhe Departamentit për Politikat e Personelit dhe Rekrutim
- Arkivit të KPMSHCK-së.